



**Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 595/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të bërges së fushatës zgjedhore gjatë ditës së zgjedhjeve, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 250 (dyqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 04. 11. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga BIRN, në të cilën theksohet se me datën 03.11.2013 deputetja nga subjekti politik LDK Alma Lama ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë fushatë përmes postimit të fotografisë së përgatitur për fushatë zgjedhore ku ajo shihet me deputeten tjetër Vjosa Osmani pranë posterit të LDK-së, andaj me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës ky veprim bie ndesh me dispozitat e LZP-së

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LDK, me datën 05.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kérkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.11.2013, ora 10:00. PZAP-i sipas afatit te caktuar pranoi përgjigjen në ankesë nga LDK-ja e në të cilën theksohet se nga fotografia e postuara në rrjetin social faceebok nuk garantohet për autenticitetin e saj sepse fotografi të tillë të postuara në llogarit e individëve e individëve të ndyshëm dhe të panjohur e të falsifikuar mund të gjinden mund të gjendet me dhjetëra të falsifikuara dhe se fotot e ofruara si dëshmi nuk bënë thirrje apo ftesë për të votuar ndonjë subjekt politik. Andaj mbi këtë bazë LDK propozon që ankesa të hedhet si e pabazë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës shihet qartë se si deputetja e LDK-së Alma Lama së bashku me deputeten tjetër Vjosa Osmani me datën 03

nëntor gjatë ditës së zgjedhjeve duke bërë fushatë dhe duke bërë postimin e fotografisë me nr. rendor te LDK-së 78 e që kjo foto ka karakter zgjedhor, andaj këto veprime janë në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) të LZP-së e cilat përcaktonë që njëzetekatër (24) orë para hapjes së qendrave të voimit për hedhjen e votes e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mështetesve ose kandidateve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfardo mënyre.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i vlerëson se subjekti politik LDK në këtë rast ka thyer kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë, pasi që shkelje të natyres së tillë ka kryer edhe më pare gjë që konsiderohet si recidivist. Andaj mbi ktë bazë si dhe në kuptim të nenit 36.1 pika b) dhe nenit 118.1 lidhur me nenin 120 paragrafi 1 pika (c) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 595/2013 më datën 07.11.2013.



#### **Këshillë Juridike:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshire është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*